



Strasbourg, 15 January 2025

CDL-REF(2025)006

Engl. only

EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW
(VENICE COMMISSION)

KOSOVO

**DRAFT LAW ON RECRUITMENT, PERFORMANCE EVALUATION,
INTEGRITY CONTROL, AND STATUS OF
JUDGES AND PROSECUTORS**



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**PROJEKTLIGJ PËR REKRUTIMIN, VLERËSIMIN E PERFORMANCËS, KONTROLLIN E INTEGRITETIT DHE
STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE**

**DRAFT LAW ON RECRUITMENT, PERFORMANCE EVALUATION, INTEGRITY CONTROL, AND STATUS
OF JUDGES AND PROSECUTORS**

**NACRT ZAKONA O REGRUTOVANJU, VREDNOVANJU RADA, KONTROLI INTEGRITETA I STATUSU
SUDIJA I TUŽILACA**

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p>LIGJ PËR PËR REKRUTIMIN, VLERËSIMIN E PERFORMANCËS, KONTROLLIN E INTEGRITETIT DHE STATUSIN E GJYQITARËVE DHE PROKURORËVE</p> <p>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Ky Ligj përcakton rregullat e rekrutimit, vlerësimit të performancës, kontrollit të integritetit, statusit dhe çështje tjera lidhur me gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Kosovës.</p> <p>Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>1. Ky Ligj zbatohet për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Kosovës dhe kandidatët për këto pozita, si dhe të gjitha autoritetet tjera të përcaktuara shprehimisht në këtë Ligj.</p>	<p>Assembly of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo</p> <p>Adopts:</p> <p>LAW ON RECRUITMENT, PERFORMANCE EVALUATION, INTEGRITY CONTROL, AND STATUS OF JUDGES AND PROSECUTORS</p> <p>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>This Law shall define the rules for recruitment, performance evaluation, integrity control, status and other matters related to judges and prosecutors in the Republic of Kosovo.</p> <p>Article 2 Scope</p> <p>1. This Law shall apply to all judges and prosecutors in the Republic of Kosovo, as well as candidates for these positions, and all other authorities expressly specified in this Law.</p>	<p>Skupština Republike Kosovo,</p> <p>U skladu sa članom 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p>ZAKONA O REGRUTOVANJU, VREDNOVANJU RADA, KONTROLI INTEGRITETA I STATUSU SUDIJA I TUŽILACA</p> <p>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</p> <p>Član 1. Cilj</p> <p>Ovaj zakon utvrđuje pravila regrutovanja, vrednovanja rada, kontrolu integriteta, napredovanja, statusa i druga pitanja u vezi sa sudijama i tužiocima u Republici Kosovo.</p> <p>Član 2. Delokrug</p> <p>1. Ovaj zakon se primenjuje na sve sudije i tužioce u Republici Kosovo i kandidate za ove pozicije, kao i na sve druge organe izričito utvrđene ovim zakonom.</p>
---	--	---

<p>2.Ky Ligj nuk zbatohet për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1.Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. Këshilli përkatës – Këshilli Gjyqësor ose Këshilli Prokurorial, varësisht nga çështja përkatëse që rregullohet për gjyqtarin ose prokurorin.</p> <p>1.2. Pasuri e pajustificueshme – sipas përkufizimit në ligjin përkatës për pasurinë e pajustificueshme.</p>	<p>2. This Law shall not apply to judges of the Constitutional Court of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1.Terms used in this Law shall have the following meaning:</p> <p>1.1. Relevant Council - Judicial Council or Prosecutorial Council, depending on the respective case governed by the judge or prosecutor.</p> <p>1.2. Unjustified assets – as defined by the relevant law on unjustified assets.</p>	<p>2. Ovaj zakona se ne primenjuje na sudije Ustavnog suda Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Član 3. Definicije</p> <p>1.Izrazi koji su korišćeni u ovom zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. Relevantni savet - Sudski savet ili Tužilački savet, u zavisnosti od relevantnog pitanja koje se uređuje za sudiju ili tužioca.</p> <p>1.2. Neopravdana imovina - prema definiciji u odgovarajućem zakonu o neopravdanoj imovini.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Funkcioni i gjyqtarit dhe prokurorit</p> <p>1.Gjyqtar në Republikën e Kosovës është personi që emërohet në bazë të Kushtetutës dhe ligjit, për të ushtruar funksion gjyqësor në një gjykatë në Republikën e Kosovës.</p> <p>2.Prokuror në Republikën e Kosovës është personi që emërohet në bazë të Kushtetutës dhe ligjit për të ushtruar funksion prokurorial në një nga Prokuroritë e Republikës e Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Function of the judge and prosecutor</p> <p>1. A judge in the Republic of Kosovo shall be a person appointed based on the Constitution and the Law, to exercise judicial functions in a Court in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. A prosecutor in the Republic of Kosovo shall be a person appointed based on the Constitution and the Law to exercise a prosecutorial function in one of the Prosecution Offices of the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;">Član 4. Funkcija sudije i tužioca</p> <p>1. Sudija u Republici Kosovo je lice koje je imenovano na osnovu Ustava i zakona, za vršenje sudijske funkcije na sudu u Republici Kosovo.</p> <p>2. Tužilac u Republici Kosovo je lice koje je imenovano na osnovu Ustava i zakona, za vršenje tužilačke funkcije u jednoj od tužilaštava Republike Kosovo.</p>

<p>3. Gjyqtari dhe prokurori ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me Kushtetutën, ligjin dhe rregullat etike, duke u bazuar në parimet e pavarësisë, paanshmërisë, integritetit, përshtatshmërisë, barazisë dhe profesionalizmit.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI II REKRUTIMI, EMËRIMI DHE RI EMËRIMI I GJYQTARIT DHE PROKURORIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Kushtet për emërimin e gjyqtarit dhe prokurorit</p> <p>1. Kushtet e përgjithshme për emërimin e kandidatit në funksionin e gjyqtarit ose prokurorit janë si në vijim:</p> <p>1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2. të ketë diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.3. të ketë të kryer Provimin e Jurisprudencës, të vlefshëm në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.4. të ketë integritet;</p>	<p>3. The judge and prosecutor shall exercise their functions in accordance with the Constitution, the Law and ethical rules, based on the principles of independence, impartiality, integrity, suitability, equality and professionalism.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER II RECRUITMENT, APPOINTMENT AND REAPPOINTMENT OF JUDGES AND PROSECUTORS</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Conditions for the appointment of a judge and prosecutor</p> <p>1. The general conditions for the appointment of a candidate to the position of judge or prosecutor shall be as follows:</p> <p>1.1. be a citizen of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. have a valid degree from the Faculty of Law in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3. have passed the Bar Examination, valid in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.4. have integrity;</p>	<p>3. Sudija i tužilac vrše svoje funkcije u skladu sa Ustavom, zakonom i etičkim pravilima, u skladu sa principima nezavisnosti, nepristrasnosti, integriteta, podobnosti, jednakosti i profesionalizma.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE II REGRUTOVANJE, IMENOVANJE I PONOVO IMENOVANJE SUDIJE I TUŽIOCA</p> <p style="text-align: center;">Član 5. Uslovi za imenovanje sudije i tužioca</p> <p>1. Opšti uslovi za imenovanje kandidata u funkciji sudije ili tužioca su sledeći:</p> <p>1.1. da je državljanin Republike Kosovo;</p> <p>1.2. da ima diplomu Pravnog fakulteta, važeću u Republici Kosovo;</p> <p>1.3. da je položio Pravosudni ispit, važeći u Republici Kosovo;</p> <p>1.4. da ima integritet;</p>
---	--	--

<p>1.5. të mos ketë aktakuzë të ngritur ose të mos jetë dënuar për vepër penale, me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia;</p> <p>1.6. të ketë së paku tre (3) vite përvojë të punës profesionale në fushën juridike, dhe</p> <p>1.7. të ketë kaluar provimin për gjyqtar për funksionin e gjyqtarit, ndërsa provimin për prokuror për funksionin e prokurorit.</p> <p>2.Për qëllime të këtij neni, përvoja në fushën juridike përfshin përvojën, duke mos u kufizuar, në çështjet juridike në institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare.</p> <p>3.Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK) sipas kompetencave të tyre sigurojnë që përbërja e gjyqësorit dhe prokurorisë pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore.</p> <p>4.Këshillat i japin përparësi për emërim si gjyqtarë dhe prokurorë, anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuar, si dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve nga gjinia e nën përfaqësuar, duke ofruar mundësi të veçanta të rekrutimit, transferimit dhe avancimit.</p>	<p>1.5. have no indictment filed against him/her or have not been convicted of a criminal offence, except for offences committed through negligence;</p> <p>1.6. have at least three (3) years of professional work experience in the legal area, and</p> <p>1.7. have passed the judge exam for the position of the judge, and the prosecutor have passed the exam for the position of the prosecutor.</p> <p>2. For the purposes of this Article, experience in the legal area shall include experience, without limitation, in legal matters within institutions and local and international organizations.</p> <p>3. The Kosovo Judicial Council (hereinafter: KJC) and the Kosovo Prosecutorial Council (hereinafter: KPC) shall, in line with their powers, ensure that the composition of the judiciary and the prosecutorial system reflects the ethnic diversity of Kosovo and the principles of gender equality.</p> <p>4.The Councils shall prioritize the appointment of judges and prosecutors from underrepresented communities, as well as judges and prosecutors from underrepresented genders, by offering special opportunities for recruitment, transfer and promotion.</p>	<p>1.5. da nema podignutu optužnicu ili da nije osuđivan za krivično delo, izuzev krivičnih dela učinjenih iz nehata;</p> <p>1.6. da ima najmanje tri (3) godine stručnog radnog iskustva u oblasti prava, i</p> <p>1.7. da ima položen ispit za sudiju za funkciju sudije, dok ispit za tužioca za funkciju tužioca.</p> <p>2. Za svrhe ovog člana, iskustvo u oblasti prava obuhvata iskustvo, ne ograničavajući se, na iskustvo u pravnim pitanjima u domaćim i međunarodnim institucijama i organizacijama.</p> <p>3. Sudski savet Kosova (u daljem tekstu: SSK) i Tužilački savet Kosova (u daljem tekstu: TSK) u skladu sa svojim nadležnostima obezbeđuju da sastav sudstva i tužilaštva odražava etničku raznolikost Kosova i principe rodne ravnopravnosti.</p> <p>4. Prilikom imenovanja sudija i tužilaca, saveti daju prednost pripadnicima manje zastupljenih zajednica, kao i sudijama i tužiocima iz manje zastupljenih polova, pružajući im posebne mogućnosti za regrutovanje, premeštaj i napredovanje.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 6 Rekrutimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Recruitment of judges and prosecutors</p>	<p style="text-align: center;">Član 6. Regrutovanje sudija i tužilaca</p>
<p>1.Procesi për rekrutimin e kandidatëve për t'u emëruar gjyqtar zhvillohet nga KGJK, ndërsa procesi për rekrutimin e kandidatëve për prokurorë nga KPK, në përputhje me Kushtetutën dhe kushtet e përcaktuara me ligj.</p> <p>2.Këshilli përkatës përmes njoftimit publik fton të gjithë profesionistët e kualifikuar ligjorë që të aplikojnë për rekrutim për gjyqtar, përkatësisht prokuror.</p> <p>3.Rekrutimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve zhvillohet në përputhje të plotë me parimin e meritokracisë, integritetit dhe transparencës gjatë procesit.</p> <p>4.KGJK dhe KPK themelojnë Komisionet përkatëse të veçanta brenda këshillave, të cilat administrojnë procesin e rekrutimit.</p> <p>5.Me rastin e rekrutimit të një kandidati, Komisioni përkatës në mes tjerash do të marrë parasysh kriteret në vijim për kandidatin:</p> <p style="padding-left: 20px;">5.1. njohuritë profesionale, përvojën e punës dhe performancën, përfshirë njohuritë dhe respektimin e të drejtave të njeriut;</p>	<p>1. The process for recruiting candidates to be appointed as judges shall be conducted by the KJC, while the process for recruiting candidates for prosecutors shall be conducted by the KPC, in accordance with the Constitution and the conditions specified by Law.</p> <p>2. The respective Council shall, through public announcement, invite all qualified legal professionals to apply for recruitment as judges or prosecutors, respectively.</p> <p>3. The recruitment of judges and prosecutors shall be conducted in full accordance with the principles of meritocracy, integrity and transparency throughout the process.</p> <p>4. The KJC and KPC shall establish respective specialized committees within the Councils, which shall administer the recruitment process.</p> <p>5. In the case of recruiting a candidate, the relevant Committee shall, among other criteria, consider the following for the candidate:</p> <p style="padding-left: 20px;">5.1. professional knowledge, work experience and performance, including the understanding and respect for human rights;</p>	<p>1. Proces regrutovanja kandidata za imenovanje za sudiju sprovodi SSK, dok proces regrutovanja kandidata za tužioca sprovodi TSK, u skladu sa Ustavom i uslovima utvrđenim zakonom.</p> <p>2. Relevantni Savet putem javnog obaveštenja poziva sve kvalifikovane pravne stručnjake da podnose prijave za regrutovanje za sudije, odnosno tužioce.</p> <p>3. Regrutovanje sudija i tužilaca održava se u potpunosti u skladu sa principom zaslug, integriteta i transparentnosti tokom procesa.</p> <p>4. SSK i TSK obrazuju posebne relevantne komisije u okviru saveta, koje upravljaju procesom regrutovanja.</p> <p>5. Prilikom regrutovanja jednog kandidata, relevantna komisija, između ostalog, uzeće u obzir sledeće kriterijume za kandidata:</p> <p style="padding-left: 20px;">5.1. stručno znanje, radno iskustvo i učinak, uključujući znanje i poštovanje ljudskih prava;</p>

<p>5.2. kapacitetin për arsyetime ligjore të dëshmuar përmes veprimtarive profesionale;</p> <p>5.3. aftësinë profesionale bazuar në rezultatet e karrierës së mëparshme, përfshirë pjesëmarrjen në forma të organizuara të trajnimit ku është vlerësuar performanca;</p> <p>5.4. aftësinë dhe kapacitetin në analizimin e problemeve ligjore;</p> <p>5.5. aftësinë për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndershme me kujdes dhe me përgjegjësi, dhe</p> <p>5.6. aftësinë komunikuese.</p> <p>6. Në procesin e rekrutimit garantohej e drejta në ankesë në Këshillin përkatës, kundër vendimeve të komisionit rekrutues.</p> <p>7. Në përfundim të procesit të rekrutimit, Këshilli përkatës propozon kandidatin për emërim për gjyqtar ose prokuror.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Gjyqtarët porotë</p> <p>1. Në rast se parashihet me ligj të veçantë, në funksion gjyqësor të caktuar mund të emërohet gjithashtu gjyqtari porot.</p>	<p>5.2. capacity for legal reasoning demonstrated through professional activities;</p> <p>5.3. professional ability based on past career results, including participation in organized forms of training where performance has been evaluated;</p> <p>5.4. ability and capacity to analyze legal issues;</p> <p>5.5. ability to perform duties impartially, honestly, carefully and responsibly, and</p> <p>5.6. communication skills.</p> <p>6. During the recruitment process, the right to appeal to the relevant Council against decisions of the Recruitment Committee shall be guaranteed.</p> <p>7. At the end of the recruitment process, the respective Council shall propose the candidate for appointment as a judge or prosecutor.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Lay judges</p> <p>1. If provided for by special Law, lay judges may also be appointed to certain judicial functions.</p>	<p>5.2. kapacitete za zakonska obrazloženja dokazane kroz stručne delatnosti;</p> <p>5.3. stručne veštine zasnovane na rezultate pređašnje karijere, uključujući učešće u organizovanim oblicima obuke gde se vrednuje rad;</p> <p>5.4. veštine i kapacitete u analiziranju pravnih problema;</p> <p>5.5. veštine za vršenje dužnosti nepristrasno, pošteno, pažljivo i odgovorno, i</p> <p>5.6. komunikacione veštine.</p> <p>6. U procesu regrutovanja garantovano je pravo žalbe relevantnom Savetu, na odluke komisije za regrutovanje.</p> <p>7. Na kraju procesa regrutovanja, relevantni Savet predlaže kandidata za imenovanje kao sudija ili tužilac.</p> <p style="text-align: center;">Član 7. Sudije porotnici</p> <p>1. Ako je propisano posebnim zakonom, na određenu funkciju sudije može biti imenovan i sudija porotnik.</p>
---	---	--

<p>2.Kushtet e përgjithshme për emërimin e kandidatit në funksionin e gjyqtarit porot janë si në vijim:</p> <p>2.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;</p> <p>2.2. të këtë moshën më se paku njëzetepesë (25) vjeçare;</p> <p>2.3. të ketë përfunduar me sukses trajnimin e kërkuar për gjyqtar porot;</p> <p>2.4. të mos ketë aktakuzë të ngritur ose të mos jetë dënuar për vepër penale me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia;</p> <p>2.5. të ketë reputacion të lartë moral në shoqëri dhe integritet.</p> <p>3.Procesi i rekrutimit të gjyqtarëve porotë, trajnimi, vlerësimi dhe të drejtat e detyrimit e tyre, përcaktohen me rregullore të miratuar nga KGJK.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve</p> <p>1. Këshilli përkatës, pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit i dërgon Presidentit propozimet e kandidatëve për t'u emëruar gjyqtarë ose prokurorë me mandat fillestar tre (3) vjeçar.</p>	<p>2. The general conditions for the appointment of a candidate to the position of lay judge shall be as follows:</p> <p>2.1. be a citizen of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.2. be at least twenty-five (25) years old;</p> <p>2.3. have successfully completed the required training for lay judges;</p> <p>2.4. have no indictment filed against him/her or have not been convicted of a criminal offence, except for offences committed through negligence;</p> <p>2.5. have a high moral reputation in society and integrity.</p> <p>3. The recruitment process of lay judges, their training, evaluation and their rights and obligations shall be defined by regulations approved by the KJC.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Appointment of judges and prosecutors</p> <p>1. After developing the recruitment procedures, the respective Council shall send to the President the proposed candidates for appointment as judges or prosecutors with an initial term of three (3) years.</p>	<p>2. Opšti uslovi za imenovanje kandidata u funkciji sudije porotnika su sledeći:</p> <p>2.1.da je državljanin Republike Kosovo;</p> <p>2.2. da ima najmanje dvadeset pet (25) godina;</p> <p>2.3. da je uspešno završio potrebnu obuku za sudiju porotnika;</p> <p>2.4. da nema podignutu optužnicu ili da nije osuđivan za krivično delo, izuzev krivičnih dela učinjenih iz nehata;</p> <p>2.5. da ima visoki moralni ugled u društvu i integritet.</p> <p>3. Proces regrutovanja sudija porotnika, obuka, vrednovanje rada i njihova prava i obaveze utvrđuju se uredbama koje donosi SSK.</p> <p style="text-align: center;">Član 8. Imenovanje sudija i tužilaca</p> <p>1. Relevantni savet, nakon odvijanja postupaka regrutovanja, dostavlja Predsedniku predloge kandidata za imenovanje za sudije ili tužioce sa početnim mandatom od tri (3) godine.</p>
---	--	--

<p>2. Propozimi nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin një raport me shkrim për kandidatin.</p> <p>3. Presidenti emëron gjyqtarët dhe prokurorët me mandat fillestar tre (3) vjeçar bazuar në propozimet e këshillave.</p> <p>4. Presidenti, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për emërimin në detyrë të gjyqtarit, gjegjësisht prokurorit, të kandidatit të propozuar nga Këshilli përkatës.</p> <p>5. Nëse brenda afatit nga paragrafi 4, Presidenti nuk e emëron gjyqtarin ose prokurorin, Këshilli përkatës mund ta paraqesë edhe një herë tjetër kandidatin e propozuar së bashku me arsyetimin plotësues në formë të shkruar. Pas kësaj Presidenti emëron gjyqtarin ose prokurorin sipas propozimit të Këshillit.</p>	<p>2. The proposal from paragraph 1 of this Article shall include a written report on the candidate.</p> <p>3. The President shall appoint judges and prosecutors with an initial term of three (3) years based on the proposals of the Councils.</p> <p>4. Within sixty (60) days after receiving the proposal, the President shall issue a decree on the appointment to the position of judge, respectively prosecutor, of the candidate proposed by the respective Council.</p> <p>5. If, within the period specified in paragraph 4, the President does not appoint the judge or prosecutor, the respective Council may present the proposed candidate once again along with additional written justification. The President shall thereafter appoint the judge or prosecutor according to the proposal of the Council.</p>	<p>2. Predlog iz stava 1. ovog člana uključuje pismeni izveštaj za kandidata.</p> <p>3. Predsednik imenuje sudije i tužioce sa početnim mandatom od tri (3) godine na osnovu predloga saveta.</p> <p>4. Predsednik u roku od šezdeset (60) dana, nakon prijema predloga, donosi dekret o imenovanju na dužnosti sudije, odnosno tužioca, predloženog kandidata od odgovarajućeg Saveta.</p> <p>5. Ako u roku iz stava 4., Predsednik ne imenuje sudiju ili tužioca, odgovarajući savet može podneti još jednom predloženog kandidata zajedno sa dopunskim obrazloženjem u pisanom obliku. Nakon toga Predsednik imenuje sudiju ili tužioca na predlog Saveta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Trajnimi fillestar</p> <p>1. Pas emërimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, gjyqtarët dhe prokurorët, do t'i nënshtrohen trajnimit fillestar, i cili organizohet nga Akademia e Drejtësisë.</p> <p>2. Trajnimi fillestar do të zgjasë dymbëdhjetë (12) muaj, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Initial training</p> <p>1. Following the appointment from the President of the Republic of Kosovo, judges and prosecutors shall undergo the initial training administered by the Academy of Justice.</p> <p>2. The initial training shall last twelve months, in line with the relevant legislation in force.</p>	<p style="text-align: center;">Član 9. Početna obuka</p> <p>1. Nakon imenovanja od Predsednika Republike Kosova, sudije i tužiocci će podležti početnoj obuci, koja se organizuje od Akademije pravde.</p> <p>2. Početna obuka će trajati dvanaest (12) meseci, u skladu sa odgovarajućim zakonodavstvom na snazi.</p>

<p>3. Gjatë trajnimit fillestar, gjyqtarëve dhe prokurorëve mund t'u caktohen raste nën mbikëqyrjen e mentorit.</p> <p>4. Gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar vlerësohen për pjesën teorike të trajnimit fillestar nga Akademia e Drejtësisë dhe për pjesën e rasteve të caktuara nga mentorët e tyre. Dosja e këtij vlerësimi bëhet pjesë e vlerësimit të performancës, së gjyqtarit gjegjësisht prokurorit me mandat fillestar, që zhvillohet nga Komisioni për Vlerësim të Pefromancës.</p> <p>5. Periudha e trajnimit fillestar do të vazhdohet për ata gjyqtarë dhe prokurorë që dështojnë të përfundojnë në mënyrë të suksesshme trajnimin fillestar, siç është përcaktuar nga Këshillat përkatës.</p>	<p>3. During the initial training, judges and prosecutors may be assigned cases under the supervision of a mentor.</p> <p>4. Judges and prosecutors appointed shall be evaluated on the theoretical part of the initial training by the Academy of Justice and on specific cases by their mentors. The file of this evaluation shall become part of the performance evaluation of the judge or prosecutor with an initial mandate, conducted by the Performance Evaluation Committee.</p> <p>5. The initial training period shall continue for those judges and prosecutors who fail to successfully complete the initial training, as determined by the respective Councils.</p>	<p>3. Tokom početne obuke, sudijama i tužiocima se mogu određivati slučajevi pod nadzorom mentora.</p> <p>4. Imenovane sudije i tužiocci se vrednuju za teorijski deo početne obuke od strane Akademije pravde i u određenim slučajevima od strane njihovih mentora. Dosije ovog vrednovanja postaje deo vrednovanja rada sudije odnosno tužioca sa početnim mandatom, koju vrši Komisija za vrednovanje rada.</p> <p>5. Period početne obuke biće produžen za one sudije i tužioce koji ne uspeju završiti početnu obuku, kako je utvrđeno od strane relevantnih Saveta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Betimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve</p> <p>1. Gjyqtari dhe prokurori i sapoemëruar me mandat fillestar tre (3) vjeçar, merr detyrën pasi të ketë dhënë betimin para Presidentit.</p> <p>2. Teksti i betimit është si në vijim: <i>“Betohej solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndroj kurdoherë besnik Republikës së Kosovës, Kushtetutës, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale si dhe do t'i kryej me besnikëri në mënyrë të pavarur profesionale dhe të paanshme detyrat dhe funksionet që më janë besuar”.</i></p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Taking the oath by judges and prosecutors</p> <p>1. The newly appointed judge and prosecutor with an initial term of three (3) years shall assume their duties after taking the oath before the President.</p> <p>2. The oath text is as follows: <i>“I solemnly swear that during the performance of my duties, I shall always remain loyal to the Republic of Kosovo, the Constitution, and the applicable laws, and shall comply with the rules of professional ethics as well as faithfully and independently perform the tasks and functions entrusted to me in a professional and impartial manner”.</i></p>	<p style="text-align: center;">Član 10. Zakletva sudija i tužilaca</p> <p>1. Novoimenovani sudija i tužilac sa početnim mandatom od tri (3) godine, stupa na dužnost nakon polaganja zakletve pred Predsednikom.</p> <p>2. Tekst zakletve je kao u nastavku: <i>„Svečano se zaklinjem da ću tokom vršenja dužnosti uvek ostati veran Republici Kosovo, Ustavu, važećim zakonima i poštovaću pravila profesionalne etnike i takođe ću verno, profesionalno i nepristrasno vršiti dužnosti i funkcije koje su mi poverene“.</i></p>

<p>3. Betimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar me mandat fillestar tre (3) vjeçar bëhet me një ceremoni publike para Presidentit, përveç nëse Presidenti vendos ndryshe.</p> <p>4. Presidenti i Republikës së Kosovës miraton Rregullore për ceremoninë e betimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.</p>	<p>3. The oath of newly appointed judges and prosecutors with an initial term of three (3) years shall be administered in a public ceremony before the President unless otherwise decided by the President.</p> <p>4. The President of the Republic of Kosovo shall adopt a Regulation on the oath-taking ceremony of judges and prosecutors.</p>	<p>3. Zakletva novoimenovanih sudija i tužilaca sa početnim mandatom od tri (3) godine polaže se javnom ceremonijom pred Predsednikom, osim ako Predsednik odlučuje drugačije.</p> <p>4. Predsednik Republike Kosovo donosi Uredbu o ceremoniji zakletve sudija i tužilaca.</p>
<p>Neni 11 Riemërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve</p>	<p>Article 11 Reappointment of judges and prosecutors</p>	<p>Član 11. Ponovno imenovanje sudija i tužilaca</p>
<p>1. Gjyqtari dhe prokurori me mandat fillestar që ka vlerësim pozitiv të performancës, propozohet nga Këshilli përkatës për emërim me mandat të përhershëm nga Presidenti.</p> <p>2. Presidenti, brenda tridhjetë (30) ditësh, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për emërimin në detyrën e gjyqtarit gjegjësisht prokurorit të propozuar nga Këshilli përkatës, me mandat të përhershëm. Nëse brenda këtij afati Presidenti nuk e emëron gjyqtarin gjegjësisht prokurorin, Këshilli përkatës mund ta propozoj edhe një (1) herë tjetër kandidatin e propozuar së bashku me arsyetimin plotësues në formë të shkruar. Pas kësaj Presidenti emëron gjyqtarin gjegjësisht prokurorin sipas propozimit të Këshillit përkatës.</p>	<p>1. A judge and prosecutor with an initial term who receives a positive performance evaluation shall be proposed by the relevant Council for appointment with a permanent term by the President.</p> <p>2. The president shall, within thirty (30) days after receiving the proposal, issue a decree on the appointment to the position of judge, respectively prosecutor proposed by the Council, with a permanent mandate. If the President does not appoint a judge, respectively a prosecutor within this mandate, the relevant Council may propose the proposed candidate once again along with an additional written justification. The President shall thereafter appoint the judge and the prosecutor respectively, proposed by the respective Council.</p>	<p>1. Sudiju i tužioca sa početnim mandatom koji ima pozitivnu ocenu učinka, relevantni Savet predlaže Predsedniku za imenovanje sa stalnim mandatom.</p> <p>2. Predsednik, u roku od trideset (30) dana, nakon prijema predloga, donosi dekret o imenovanju na dužnosti sudije, odnosno tužioca predloženog od relevantnog Saveta sa stalnim mandatom. Ako u ovom roku Predsednik ne imenuje sudiju, odnosno tužioca, relevantni Savet može predložiti još jedan (1) put predloženog kandidata zajedno sa dopunskim obrazloženjem u pisanom obliku. Nakon toga Predsednik imenuje sudiju, odnosno tužioca, prema predlogu relevantnog Saveta.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 12 Rregulloret për rekrutim, emërim dhe riemërim</p> <p>Në bazë të përcaktimeve të këtij Ligji, KGJK miraton rregullore të veçantë për procesin e rekrutimit, emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve, ndërsa KPK rregullore të veçantë për procesin e rekrutimit, emërimit dhe riemërimit të prokurorëve.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI III USHTRIMI I FUNKSIONIT TË GJYQTARIT DHE PROKURORIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Detyrat e gjyqtarit dhe prokurorit</p> <p>1. Gjyqtari dhe prokurori veprojnë në mënyrë të pavarur, të paanshme, dhe objektive në pajtim me ligjin dhe rregullat në fuqi.</p> <p>2. Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, gjyqtari dhe prokurori demonstron disponueshmërinë, respektin për palët dhe dëshmitarët si dhe vigjilencë në ruajtjen e shkallës më të lartë të kompetencës.</p> <p>3. Gjyqtari dhe prokurori mbrojnë konfidencialitetin e çdo informacioni jopublik.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Regulations on recruitment, appointment and reappointment.</p> <p>Based on the provisions of this Law, the KJC shall adopt special regulations on the recruitment, appointment and reappointment process of judges, while the KPC shall adopt special regulations on the recruitment, appointment and reappointment process of prosecutors.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER III EXERCISE OF THE FUNCTION OF THE JUDGE AND PROSECUTOR</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Duties of judges and prosecutors</p> <p>1. The judges and prosecutors shall act independently, impartially and objectively in accordance with the applicable law and the rules.</p> <p>2. During the exercise of their duties, the judges and prosecutors shall demonstrate availability, respect for the parties and witnesses, as well as vigilance in maintaining the highest degree of competency.</p> <p>3. The judges and prosecutors shall protect the confidentiality of any non-public information.</p>	<p style="text-align: center;">Član 12. Uredbe o regrutovanju, imenovanju i ponovnom imenovanju</p> <p>Na osnovu odredbi ovog zakona, SSK donosi posebne uredbe o procesu regrutovanja, imenovanja i ponovnog imenovanja sudija, dok TSK donosi posebne uredbe o procesu regrutovanja, imenovanja i ponovnog imenovanja tužilaca.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE III VRŠENJE FUNKCIJE SUDIJE I TUŽIOCA</p> <p style="text-align: center;">Član 13. Dužnosti sudije i tužioca</p> <p>1. Sudija i tužilac deluju na nezavisan način, nepristrasno i objektivno u skladu sa zakonom i propisima na snazi.</p> <p>2. Tokom vršenja njihovih dužnosti, sudija i tužilac demonstriraju dostupnost, poštovanje za stranke i svedoke kao i opreznost u očuvanje najvišeg stepena stručnosti.</p> <p>3. Sudija i tužilac štite poverljivost svake informacije koja nije javna.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 14 Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes</p> <p>1. Gjyqtari dhe prokurori marrin të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar dinjitetin dhe standardet e funksionit të tyre, reputacionin e organeve të drejtësisë, besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe prokurorial dhe statusin e funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit.</p> <p>2. Gjyqtari dhe prokurori marrin të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur gjyqtari dhe prokurori nuk janë duke ushtruar funksionet zyrtare.</p> <p>3. KGJK miraton Kodin e Etikës profesionale për gjyqtarë dhe KPK miraton Kodin e Etikës profesionale për prokurorë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Standards of ethics and rules of conduct</p> <p>1. The judges and prosecutors shall take all measures to protect and strengthen the dignity and standards of their function, the reputation of the judicial authorities, public trust in the judicial and prosecutorial system and the status of the judge and prosecutor's function.</p> <p>2. The judges and prosecutors shall take all reasonable measures to preserve the dignity of their function, including activities performed even when the judges and prosecutors are not exercising official duties.</p> <p>3. The KJC shall adopt the Code of Professional Ethics for Judges, and the KPC shall adopt the Code of Professional Ethics for Prosecutors.</p>	<p style="text-align: center;">Član 14. Standardi etike i pravila ponašanja</p> <p>1. Sudija i tužilac preduzimaju sve mere da štite i ojačaju dostojanstvo i standarde svoje funkcije, ugled pravosudnih organa, poverenje javnosti u sudski i tužilački sistem i status funkcije sudije i tužioca.</p> <p>2. Sudija i tužilac preduzimaju sve razumne mere da očuvaju dostojanstvo funkcije, uključujući i delatnost koje obavljaju i kada sudija i tužilac ne vrše svoje službene funkcije.</p> <p>3. SSK donosi Kodeks profesionalne etike za sudije i TSK donosi Kodeks profesionalne etike za tužioce.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Zhvillimi profesional i gjyqtarit dhe prokurorit</p> <p>1. Gjyqtari dhe prokurori kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete trajnuese që kontribuojnë në zhvillimin e karrierës dhe rritjes profesionale të tyre.</p> <p>2. Gjyqtari dhe prokurori janë të detyruar të marrin pjesë në aktivitete trajnuese të përcaktuara gjatë vlerësimit të performancës, si dhe në rastet tjera të përcaktuara nga Këshilli përkatës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Professional development of judges and prosecutors</p> <p>1. Judges and prosecutors shall be entitled to participate in training activities that contribute to their career development and professional growth.</p> <p>2. Judges and prosecutors shall be obliged to participate in training activities determined during performance evaluation, as well as in cases determined by the respective Council.</p>	<p style="text-align: center;">Član 15. Stručno usavršavanje sudije i tužioca</p> <p>1. Sudija i tužilac imaju pravo da učestvuju u aktivnostima obuke koje doprinose razvoju njihove karijere i profesionalnom razvoju.</p> <p>2. Sudija i tužilac su dužni da učestvuju u aktivnostima obuke utvrđenim tokom procene učinka, kao i u drugim slučajevima utvrđenim od relevantnog Saveta.</p>

<p>3. Trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë administrohen nga Akademia e Drejtësisë, ndërsa gjyqtarët dhe prokurorët marrin pjesë edhe në trajnime tjera brenda dhe jashtë vendit sipas përcaktimeve të këshillave përkatës.</p> <p>4. Për zbatimin e këtij neni, KGJK miraton Rregullore për trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe KPK miraton Rregullore për trajnimin e vazhdueshëm të prokurorëve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Veprimtaritë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit</p> <p>1. Gjyqtari dhe prokurori me aprovimin paraprak të Këshillit përkatës, kanë të drejtë të marrin pjesë në organizata profesionale dhe takime e organizime shkencore, të cilat pasqyrojnë dhe promovojnë punën dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë, si dhe pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale përkatëse të gjyqtarëve ose prokurorëve.</p> <p>2. Gjyqtari dhe prokurori nuk mund të ushtrojnë funksion tjetër jashtë funksionit si gjyqtarë ose prokurorë brenda orarit të punës përveç përjashtimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.</p> <p>3. Gjyqtari me aprovimin e Kryetarit të Gjykatës dhe Kryetari i Gjykatës me aprovim të KGJK-së,</p>	<p>3. Training for judges and prosecutors shall be administered by the Academy of Justice, while judges and prosecutors shall also participate in other domestic or international training according to the respective council's regulations.</p> <p>4. For the implementation of this Article, the KJC shall adopt Regulations on Continuous Training of Judges, and the KPC shall adopt Regulations on Continuous Training of Prosecutors.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Professional activities of judges and prosecutors</p> <p>1. With the prior approval of the respective Council, the judges and prosecutors shall be entitled to participate in professional organizations and scientific meetings and events that reflect and promote the work and functioning of the justice system, as well as the independence and protection of the respective professional interests of judges or prosecutors.</p> <p>2. Judges and prosecutors may not exercise another function outside their function as judges or prosecutors during their working hours, save for the exceptions provided by other applicable legislation.</p> <p>3. The judge may, upon the approval of the President of the Court, and the President of</p>	<p>3. Obukama za sudije i tužioce upravlja Akademija pravde, dok sudije i tužioc i učestvuju i u drugim obukama u zemlji i inostranstvu u skladu sa odlukama relevantnih saveta.</p> <p>4. Za sprovođenje ovog člana, SSK donosi Uredbu o stalnoj obuci sudija i TSK donosi Uredbu o stalnoj obuci tužilaca.</p> <p style="text-align: center;">Član 16. Profesionalna delatnost sudije i tužioca</p> <p>1. Sudija i tužilac, uz prethodno odobrenje relevantnog Saveta, imaju pravo da učestvuju u profesionalnim organizacijama i naučnim skupovima i organizacijama, koji odražavaju i promovišu rad i funkcionisanje pravosudnog sistema, kao i nezavisnost i zaštitu relevantnih profesionalnih interesa sudija ili tužilaca.</p> <p>2. Sudija i tužilac ne mogu vršiti nikakvu drugu funkciju izvan funkcije kao sudija ili tužilac unutar radnog vremena, osim u izuzetima utvrđenim zakonodavstvom na snazi.</p> <p>3. Sudija, uz odobrenje predsednika suda i predsednik suda uz odobrenje SSK-a, može učestvovati, samo van radnog vremena, u</p>
--	---	---

<p>4.6. Regjistrat e pasurisë së deklaruar, në rast se subjekti ka deklaruar pasurinë më herët sipas ligjit të veçantë;</p>	<p>4.6. Registers of declared assets, if the subject has declared assets earlier according to the special law;</p>	<p>4.6. Registre prijavljene imovine, u slučaju da je subjekt ranije prijavio imovinu prema posebnim zakonom;</p>
<p>4.7. Punëdhënësit e kaluar dhe</p>	<p>4.7. Previous employers, and</p>	<p>4.7. Ranije poslodavce, i</p>
<p>4.8. Të dhëna tjera relevante për subjektin.</p>	<p>4.8. Other relevant data about the subject.</p>	<p>4.8. Ostalih podataka relevantnih za subjekat.</p>

<p>5. Subjektet të cilat posedojnë të dhënat apo informatat nga paragrafi 4 janë të detyruara të ofrojnë ato te njësia përkatëse për verifikim dhe të bashkëpunojnë me njësinë.</p>	<p>5. Subjects who have the data or information referred to in paragraph 4 shall be obliged to provide them to the relevant verification unit and cooperate with the unit.</p>	<p>5. Subjekti koji poseduju podatke ili informacije iz stava 4. obavezni su da ih pruže kod odgovarajuće jedinice na verifikaciju i da sarađuju sa jedinicom.</p>
<p>6. Njësia për verifikim mund të mbledh të dhëna dhe informata për të kaluarën penale nga shtetet tjera apo organizatat ndërkombëtare, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme për kontrollin e integritetit të kandidatit sipas legjislacionit në fuqi.</p>	<p>6. The verification unit shall collect the data or information about the criminal past from other countries or international organizations, if this is considered necessary to vet the candidate's integrity according to the legislation in force.</p>	<p>6. Jedinica za verifikaciju može prikupljati podatke i informacije o krivičnoj prošlosti od drugih država ili međunarodnih organizacija, u slučaju da se to proceni potrebnim za kontrolu integriteta kandidata prema zakonodavstvom na snazi.</p>
<p>7. Subjekti i kontrollit njoftohet paraprakisht me raportin e Njesisë përkatëse me të dhënat e mbledhura, për të cilin mund të paraqes argumentet e tij.</p>	<p>7. The subject of verification shall be informed in advance about the respective Unit's report with the collected date, on which they can present their own arguments.</p>	<p>7. Subjekat kontrole se unapred obaveštava sa izveštajem relevantne Jedinice sa prikupljenim podacima, za šta može da predoči svoje argumente.</p>
<p>8. Gjetjet e njësisë përkatëse për verifikim dhe argumentet e subjektit të kontrollit bëhen pjesë e Raportit final të verifikimit i cili i paraqitet komisionit përkatës për rekrutim.</p>	<p>8. The findings of the respective verification unit and the arguments of the subject of the control shall be part of the final Verification Report which is presented to the respective recruitment committee.</p>	<p>8. Nalazi odgovarajuće jedinice za verifikaciju i argumenti subjekta kontrole postaju deo konačnog Izveštaja o verifikaciji koji se predočava relevantnoj komisiji za regrutovanje.</p>
<p>9. Të dhënat dhe informata tjera të pranuar nga Njësia, përveç atyre sipas paragrafit 4 të këtij neni, trajtohen nga Njësia dhe bëhen pjesë e Raportit vetëm nëse konfirmohen nga institucionet publike përkatëse.</p>	<p>9. Other data and information received by the Unit shall, in addition to those referred to in paragraph 4 of this article, be addressed by the Unit and become part of the Report only if they are confirmed by the relevant public institutions.</p>	<p>9. Podaci i druge informacije primljene od Jedinice, osim onih iz stava 4 ovog člana, tretiraju se od Jedinice i postaju deo Izveštaja samo ako se potvrde od relevantne javne institucije.</p>
<p>10. Komisioni përkatës për Rekrutim vlerëson Raportin e përgatitur dhe mund të kërkoj verifikime shtesë nga njësia përkatëse si dhe diskutoj çështjet e ngritura në Raport gjatë</p>	<p>10. The relevant Recruitment committee shall evaluate the produced Report and may require additional verification by the relevant unit as well as discuss the issues raised in the</p>	<p>10. Relevantna Komisija za regrutovanje ocenjuje pripremljeni Izveštaj i može zahtevati dodatne verifikacije od odgovarajuće jedinice, kao i diskutovati o pitanjima pokrenutim u</p>

<p>procesit të intervistës me kandidatin për gjyqtar apo prokuror.</p> <p>11. Gjatë procesit të kontrollit të integritetit sigurohet mbrojtja e të dhënave personale të kandidatit sipas kërkesave të ligjit përkatës.</p> <p>12. Këshillat përkatës nxjerrin akte nënligjore për caktimin e rregullave dhe procedurës për kontrollin e integritetit të kandidatëve për gjyqtarë gjegjësisht prokurorë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 29 Kontrolli i integritetit për gjyqtarët dhe prokurorët me mandat fillestar</p> <p>1. Këshillat përkatës zhvillojnë procedurën e kontrollit të integritetit për gjyqtarët dhe prokurorët me mandat fillestar, para përfundimit të mandatit të tyre fillestar.</p> <p>2. Procedura e kontrollit të integritetit nga paragrafi 1 i këtij neni mbështetet nga njësia përkatëse për verifikim në kuadër të Këshillit përkatës.</p> <p>3. Kontrolli i integritetit për gjyqtarët dhe prokurorët me mandat fillestar përfshin kontrollin e veprimeve të së kaluarës nga momenti i emërimit, duke përfshirë kontrollin nëse kandidati është dënuar për vepër penale, i janë shqiptuar masa disiplinore, kontrollin e pasurisë së tij sipas ligjit të veçantë, si dhe çdo veprim tjetër që e bën</p>	<p>Report during the interview process with the candidate judge or prosecutor.</p> <p>11. During the integrity control process, protection of the candidate's personal data shall be ensured according to the relevant law.</p> <p>12. The respective Councils shall issue a bylaw defining the rules and procedure for the integrity control of the candidates for judge and prosecutor respectively.</p> <p style="text-align: center;">Article 29 Integrity control for judges and prosecutors with an initial mandate</p> <p>1. The respective Councils shall develop the integrity control procedure for judges and prosecutors with an initial mandate, before their initial mandate ends.</p> <p>2. The integrity control procedure from paragraph 1 of this article shall be supported by the relevant vetting unit within the respective Council.</p> <p>3. The integrity control for judges and prosecutors with an initial mandate shall include checking past actions from the moment of appointment, including whether the candidate has been convicted of a criminal offense, disciplinary measures have been imposed against them, checking their assets according to a special law, as well as any other</p>	<p>Izveštaju tokom procesa intervjuja sa kandidatom za sudiju ili tužioca.</p> <p>11. Tokom procesa kontrole integriteta obezbeđuje se zaštita ličnih podataka kandidata prema zahtevima odgovarajućeg zakona.</p> <p>12. Relevantni Saveti donose podzakonske akte o određivanju pravila i postupka za kontrolu integriteta kandidata za sudiju odnosno tužioca.</p> <p style="text-align: center;">Član 29. Kontrola integriteta za sudije i tužioce sa početnim mandatom</p> <p>1. Relevantni saveti spdo vode postupak kontrole integriteta za sudije i tužioce sa početnim mandatom, pre isteka njihovog početnog mandata.</p> <p>2. Postupak kontrole integriteta iz stava 1 ovog člana podržava se od strane relevantne jedinice za verifikaciju u okviru relevantnog Saveta.</p> <p>3. Kontrola integriteta za sudije i tužioce sa početnim mandatom uključuje kontrolu prošlih radnji od trenutka imenovanja, uključujući kontrolu da li je kandidat osuđivan za krivično delo, da li su mu izrečene disciplinske mere, kontrolu njegove imovine u skladu sa posebnim zakonom, kao i svaku drugu radnju</p>
---	--	--

<p>të padenjë për të ushtruar funksionin e gjyqtarit ose prokurorit me mandat të përhershëm.</p> <p>4. Për kontrollin e integritetit nga ky nen, njësia përkatëse për verifikim përdor burimet e të dhënave dhe informatave të përcaktuara në nenin 28 të këtij Ligji, si dhe zbatohen të drejtat për subjektin e kontrollit dhe detyrimet për organet publike dhe subjektet private të përcaktuara në atë nen.</p> <p>5. Të gjeturat e Njesisë përkatëse për verifikim dhe argumentet e subjektit të kontrollit bëhen pjesë e raportit të verifikimit i cili i paraqitet Këshillit përkatës.</p> <p>6. Këshilli vlerëson raportin e përgatitur dhe mund të kërkoj verifikime shtesë nga njësia përkatëse si dhe diskutoj çështjet e ngritura në raport me gjyqtarin gjegjësisht prokurorin me mandat fillestar. Të gjeturat e raportit shërbejnë në procesin e vendimmarrjes së Këshillit përkatës për propozimin apo jo për emërim të gjyqtarit gjegjësisht prokurorit me mandat të përhershëm.</p> <p>7. Këshillat përkatës nxjerrin akte nënligjore për caktimin e rregullave dhe procedurës për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve gjegjësisht prokurorëve me mandat fillestar.</p>	<p>action that makes them unfit to exercise the function of a judge or prosecutor with a permanent mandate.</p> <p>4. For the integrity control referred to in this article, the relevant vetting unit shall use the sources of data and information defined in Article 28 of this Law, as well as the rights of the control subject and the obligations for public bodies and private entities defined in that article shall be applied.</p> <p>5. The findings of the relevant vetting Unit and the arguments of the subject of control shall be included in the Verification Report presented to the respective Council.</p> <p>6. The Council shall evaluate the prepared Report and may request additional verifications from the relevant unit as well as discuss the issues raised in the Report with the judge or the prosecutor with an initial mandate. The findings of the Report serve in the decision-making process of the respective Council whether or not to propose for appointment a judge or prosecutor with a permanent mandate.</p> <p>7. The respective Council shall issue a bylaw to define the rules of procedure for the integrity control of judges and prosecutors with an initial mandate.</p>	<p>koja ga čini nedostojnim za vršenje funkcije sudije ili tužioca sa stalnim mandatom.</p> <p>4. Za kontrolu integriteta iz ovog člana, relevantna jedinica za verifikaciju koristi izvore podataka i informacija utvrđenih u članu 28 ovog Zakona. kao i sprovode se prava za subjekta kontrole i obaveze za javne organe i privatne subjekte utvrđene u tom članu.</p> <p>5. Nalazi relevantne Jedinice za verifikaciju i argumenti subjekta kontrole postaju deo izveštaja o verifikaciji koji se dostavlja relevantnom Savetu.</p> <p>6. Savet ocenjuje pripremljeni Izveštaj i može zahtevati dodatne verifikacije od relevantne jedinice, kao i diskutovati o pitanjima podignutim u Izveštaju sa sudijom odnosno tužiocem sa početnim mandatom. Nalazi Izveštaja služe u procesu odlučivanja relevantnog Saveta o predlogu ili ne imenovanju sudije odnosno tužioca sa stalnim mandatom.</p> <p>7. Relevantni Saveti donose podzakonske akte o određivanju pravila i postupka za kontrolu integriteta sudije odnosno tužioca sa početnim mandatom.</p>
---	--	--

<p align="center">KAPITULLI VI TRANSFERIMI DHE AVANCIMI I GJYQTARIT DHE PROKURORIT</p>	<p align="center">CHAPTER VI TRANSFER AND PROMOTION OF JUDGES AND PROSECUTORS</p>	<p align="center">POGLAVLJE VI PREMEŠTAJ I NAPREDOVANJE SUDIJE I TUŽIOCA</p>
<p align="center">Neni 30 Transferimi i gjyqtarit dhe prokurorit</p> <p>1.KGJK mund të transferojë një gjyqtar në një gjykatë tjetër dhe KPK një prokuror në një prokurori tjetër, për një periudhë të përkohshme deri në një (1) vit, pavarësisht vullnetit të tyre, në rastet kur gjykata apo prokuroria përkatëse ka numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve gjegjësisht prokurorëve, apo me qëllim të ngritjes së efikasitetit.</p> <p>2. Vendimi për transferim arsyetohet në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni.</p> <p>3. Transferi mund të vazhdohet edhe për një (1) vit tjetër në rast se vazhdojnë të plotësohen kushtet nga paragrafi 1 i këtij Neni.</p> <p>4.Transferi brenda gjykatës dhe degëve mund të bëhet nga kryetari i gjykatës sipas nevojave të organizimit të brendshëm të gjykatës, pas konfirmimit nga Këshilli, pa të drejtë kompensimi shtesë.</p> <p>5.Gjyqtarët dhe prokurorët mund të aplikojnë pranë Këshillit përkatës për transferim vullnetar të përhershëm në një gjykatë, gjegjësisht prokurori</p>	<p align="center">Article 30 Transfer of judges and prosecutors</p> <p>1. The KPC may transfer a judge to another Court and the KPC a prosecutor to another Prosecution Office for an interim period of up to one (1) year respectively, regardless their will, in cases where the respective Court or Prosecution Office has an insufficient number of judges or prosecutors, or with the aim of increasing efficiency with possibility of extension for one (1) more year.</p> <p>2. The decision for transfer shall be justified based on the conditions set out in paragraph 1 of this Article.</p> <p>3. The transfer may be extended for another one (1) year if the conditions from paragraph 1 of this Article continue to be met.</p> <p>4. Transfer within the Court and its branches may be conducted by the President of the Court according to the internal organizational needs of the Court, following the confirmation of the Council without the right to additional compensation.</p> <p>5. Judges and prosecutors may apply to the respective Council for permanent voluntary transfer to another Court or Prosecution</p>	<p align="center">Član 30. Premeštaj sudije i tužioca</p> <p>1. SSK može premestiti sudiju u drugi sud, a TSK tužioca u drugo tužilaštvo, na privremeni period do jedne (1) godine, bez obzira na njihovu volju, u slučajevima kada relevantni sud ili tužilaštvo ima nedovoljan broj sudija, odnosno tužilaca, ili u cilju povećanja efikasnosti sa mogućnošću nastavka za još (1) godinu.</p> <p>2. Odluka o premeštaju se obrazloži na osnovu uslova iz stava 1. ovog člana.</p> <p>3. Premeštaj se može produžiti za još (1) godinu ako se i dalje ispunjavaju uslovi iz stava 1. ovog člana.</p> <p>4. Premeštaj u okviru suda ili ogranaka može vršiti predsednik suda u skladu sa potrebama unutrašnje organizacije suda, nakon potvrđivanja od Saveta, bez prava na dodatnu naknadu.</p> <p>5. Sudije i tužioci mogu da podnesu zahtev relevantnom Savetu za dobrovoljni stalni premeštaj u drugi sud, odnosno tužilaštvo, na</p>

<p>tjetër, në bazë të pozitive të hapura të Këshillit përkatës.</p> <p>6. Transferimet nga ky Nen bëhen në kuadër të gjykatës, përkatësisht prokurorisë, dhe departamentit, të nivelit të njejtë. Departament i nivelit të njejtë sipas këtij paragrafi konsiderohet departamenti në të cilin vlejné kushtet e njëjta të përvojës së punës së gjyqtarit gjegjësisht prokurorit për të shërbyer aty.</p> <p>7. Në rastet e transferimit nga ky Nen, paga e gjyqtarit gjegjësisht prokurorit nuk mund të ulet.</p> <p>8. KGJK miraton rregullore për procedurën e transferimit të gjyqtarëve dhe KPK miraton rregullore për transferimin e prokurorëve, sipas përcaktimeve të këtij Neni.</p>	<p>Office, based on the vacant positions within the respective Council.</p> <p>6. The transfer from this Article shall be conducted within the same level Court or Prosecution Office and department. The department of the same level, according to this paragraph, shall be considered a department where the same conditions of work experience for the judge or prosecutor to serve there apply.</p> <p>7. In cases of transfer under this Article, the salary of the judge or prosecutor cannot be reduced.</p> <p>8. KJC shall adopt regulations on the procedure of judges' transfer and the KPC shall adopt regulations on prosecutors' transfer, according to the provisions of this Article.</p>	<p>osnovu otvorenih radnih mesta relevantnog Saveta.</p> <p>6. Premeštaji vrše se u okviru suda, odnosno tužilaštva, i odeljenja, istog stepena. Odeljenje istog stepena iz ovog stava, smatra se odeljenje u kome važe isti uslovi radnog iskustva sudije odnosno tužioca za služenje tamo.</p> <p>7. U slučaju premeštaja iz ovog člana, ne može se smanjiti plata sudije, odnosno tužioca.</p> <p>8. SSK donosi uredbu o postupku premeštaja sudija i TSK donosi uredbu o premeštaju tužilaca, u skladu sa odredbama ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 31 Caktimi i gjyqtarit mobil</p> <p>1. KGJK, pas propozimit të arsyetuar nga Kryetari i Gjykatës, mund të caktoj një gjyqtar të një Gjykate të shërbej si gjyqtar mobil për ditë të caktuara të punës, në një ose më shumë degë të asaj Gjykate.</p> <p>2. Periudha e mobilitetit të gjyqtarit mund të zgjas më së shumti një (1) vit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 32 Avancimi i gjyqtarit dhe prokurorit</p>	<p style="text-align: center;">Article 31 Assignment of a mobile judge</p> <p>1. KJC may, upon the justified proposal of the President of the Court, may assign a judge from one Court to serve as a mobile judge for specific working days in one or more branches of that Court.</p> <p>2. The period of mobility of the judge may last for up to one (1) year.</p> <p style="text-align: center;">Article 32 Promotion of judges and prosecutors</p>	<p style="text-align: center;">Član 31. Imenovanje mobilnog sudije</p> <p>1. SSK, po obrazloženog predlogu predsednika suda, može imenovati sudiju suda da radi kao mobilni sudija na određene radne dane, u jednom ili više ogranaka tog suda.</p> <p>2. Period mobilnosti sudije može se produžiti za najviše godinu dana.</p> <p style="text-align: center;">Član 32. Napredovanje sudije i tužioca</p>

<p>1. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me këtë Ligj, Gjyqtari, me qëllim të avancimit në departamentet dhe gjykatat në vijim, duhet të ketë mandat të përhershëm si gjyqtar, së paku vlerësim pozitiv të performancës dhe përvojën e punës si Gjyqtar si në vijim:</p> <p>1.1. tre (3) vite përvojë si gjyqtar në lëmin penal, për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin për Krime të Rënda, Departamentin Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, apo Departamentit për të Mitur në Gjykatën Themelore;</p> <p>1.2. pesë (5) vite përvojë si gjyqtar, për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit apo në shkallën e dytë të gjykatave të specializuara, dhe</p> <p>1.3. dhjetë (10) vite përvojë si gjyqtar, prej të cilave së paku tre (3) vite në Gjykatën Apelit apo në shkallën e dytë të gjykatave të specializuara, për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Supreme.</p> <p>2. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me këtë Ligj, Prokurori, me qëllim të emërimit apo avancimit në departamentet dhe prokuroritë në vijim, duhet të ketë mandat të përhershëm si prokuror, së paku vlerësim pozitiv të performancës dhe përvojën e punës si Prokuror si në vijim:</p>	<p>1. In addition to the general conditions stipulated by this Law, a judge, for the purpose of promotion to the following departments and Courts, must have a permanent term as a judge, at least a positive performance evaluation, and work experience as a judge as follows:</p> <p>1.1. three (3) years of experience as a judge in the criminal branch, to serve as a judge in the Serious Crimes Department, Special Department for cases within the jurisdiction of the Special Prosecution Office of the Republic of Kosovo, or the Juvenile Department in the Basic Court;</p> <p>1.2. five (5) years of experience as a judge, to serve as a judge in the Court of Appeals or the second instance of specialized courts; and</p> <p>1.3. ten (10) years of experience as a judge, of which at least three (3) years in the Court of Appeals or the second instance of specialized courts, to serve as a judge in the Supreme Court.</p> <p>2. In addition to the general conditions stipulated by this Law, a prosecutor, for the purpose of appointment or promotion to the following departments and Prosecution Offices, must have a permanent mandate as a prosecutor, at least a positive performance evaluation, and work experience as a prosecutor as follows:</p>	<p>1. Pored opštih uslova utvrđenih ovim Zakonom, sudija, u cilju napredovanja u sledećim odeljenjima i sudovima, treba da ima stalni mandat kao sudija, najmanje pozitivnu ocenu vrednovanja rada i radno iskustvo kao sudija, kao u nastavku:</p> <p>1.1. tri (3) godine iskustva kao sudija u krivičnoj oblasti, za vršenje funkcije sudije u Odeljenju za teške zločine, Specijalnom odeljenju za predmete iz nadležnosti Specijalnog tužilaštva Republike Kosovo, ili Odeljenju za maloletnike u Osnovnom sudu;</p> <p>1.2. pet (5) godina iskustva kao sudija za vršenje funkcije sudije u Apelacionom sudu ili drugostepenim specijalizovanim sudovima, i</p> <p>1.3. deset (10) godina iskustva kao sudija, od čega tri (3) godine u Apelacionom sudu ili drugostepenim specijalizovanim sudovima, za vršenje funkcije sudije u Vrhovnom sudu.</p> <p>2. Pored opštih uslova utvrđenih ovim Zakonom, tužilac, u cilju imenovanja ili napredovanja u sledećim odeljenjima i tužilaštvima, treba da ima stalni mandat kao tužilac, najmanje pozitivnu ocenu vrednovanja rada i radno iskustvo kao tužilac, kao u nastavku:</p>
---	---	--

<p>2.1. tre (3) vite përvojë si prokuror, për të ushtruar funksionin e prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda, Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës apo Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore;</p> <p>2.2. tre (3) vite përvojë si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda, Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës apo Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore, për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Apelit, dhe</p> <p>2.3. shtatë (7) vite përvojë si prokuror, prej tyre së paku tre (3) vite në Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale apo Departamentin për Krime të Rënda ose Departamentin për të Mitur të prokurorive themelore, për të ushtruar funksionin e prokurorit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.</p> <p>3. Masat disiplinore që janë pengesë për avancimin e gjyqtarit ose prokurorit përcaktohen me ligjin e veçantë për përgjegjësinë disiplinore.</p> <p>4. KGJK miraton rregullore të veçantë për procedurën e avancimit të gjyqtarëve, ndërsa KPK miraton rregullore të veçantë për procedurën</p>	<p>2.1. three (3) years of experience as a prosecutor to perform the function of a prosecutor in the Serious Crimes Department, the Special Prosecution Office of the Republic of Kosovo, or the Juvenile Department in the Basic Prosecution Office;</p> <p>2.2. three (3) years of experience as a prosecutor in the Serious Crimes Department, the Special Prosecution Office of the Republic of Kosovo, or the Juvenile Department in the Basic Prosecution Office, to perform the function of a prosecutor in the Appellate Prosecution Office; and</p> <p>2.3. seven (7) years of experience as a prosecutor, of which at least three (3) years in the Appellate Prosecution Office, the Special Prosecution Office, or the Serious Crimes Department or the Juvenile Department of the basic Prosecution Offices to perform the function of a prosecutor in the Office of the Chief State Prosecutor.</p> <p>3. Disciplinary measures that hinder the promotion of judges or prosecutors shall be determined by the special Law on Disciplinary Liability.</p> <p>4. The KJC shall adopt special regulations on the promotion procedure of judges, while the KPC shall adopt special regulations on the</p>	<p>2.1. tri (3) godine iskustva kao tužilac, za vršenje funkcije tužioca u Odeljenju za teške zločine, Specijalnom tužilaštvu Republike Kosovo ili Odeljenju za maloletnike u Osnovnom tužilaštvu;</p> <p>2.2. tri (3) godine iskustva kao tužilac u Odeljenju za teške zločine, Specijalnom tužilaštvu Republike Kosovo ili Odeljenju za maloletnike u Osnovnom tužilaštvu, za vršenje funkcije tužioca u Apelacionom tužilaštvu, i</p> <p>2.3. sedam (7) godina kao tužilac, od čega najmanje tri (3) godine u Apelacionom tužilaštvu, Specijalnom tužilaštvu ili Odeljenju za teške zločine ili Odeljenju za maloletnike osnovnih tužilaštava, za vršenje funkcije tužioca u Kancelariji Glavnog državnog tužioca.</p> <p>3. Disciplinske mere koje su prepreka napredovanju sudije ili tužioca, utvrđuju se posebnim zakonom o disciplinskoj odgovornosti.</p> <p>4. SSK donosi posebnu uredbu o postupku napredovanja sudija, dok TSK donosi posebnu uredbu o postupku napredovanja</p>
--	--	--

<p>e avancimit të prokurorëve, në bazë të përcaktimeve të këtij Ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI VII PËRFUNDIMI I MANDATIT TË GJYQTARIT OSE PROKURORIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 33 Përfundimi i mandatit</p> <p>1. Mandati i gjyqtarit ose prokurorit përfundon me:</p> <p>1.1. dorëheqje;</p> <p>1.2. shkarkim;</p> <p>1.3. marrjen e zotësisë së veprimit, me vendim të plotëfuqishëm të Gjykatës;</p> <p>1.4. vdekje;</p> <p>1.5. arritjen e moshës gjashtëdhjetepesë (65) vjeçare, dhe</p> <p>1.6. në rastet kur gjyqtari ose prokurori nuk rriemërohet me mandat të përhershëm.</p>	<p>advancement procedure of prosecutors, based on the provisions of this Law and other applicable legislation.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER VII TERMINATION OF THE TERM OF JUDGES OR PROSECUTORS</p> <p style="text-align: center;">Article 33 Termination of the term</p> <p>1. The term of a judge or prosecutor shall terminate upon:</p> <p>1.1. resignation;</p> <p>1.2. dismissal;</p> <p>1.3. withdrawal of the capacity to act by a final Court decision;</p> <p>1.4. death;</p> <p>1.5. reaching the age of sixty-five (65) years, and</p> <p>1.6. in cases where the judge or prosecutor is not reappointed with a permanent term.</p>	<p>tužilaca, na osnovu odredbi ovog zakona i drugog važećeg zakonodavstva.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE VII ZAVRŠETAK MANDATA SUDIJE ILI TUŽIOCA</p> <p style="text-align: center;">Član 33. Završetak mandata</p> <p>1. Mandat sudije ili tužioca prestaje:</p> <p>1.1. ostavkom;</p> <p>1.2. razrešenjem;</p> <p>1.3. oduzimanjem poslovne sposobnosti, pravosnažnom odlukom Suda;</p> <p>1.4. smrću;</p> <p>1.5. navršnim šezdeset pet (65) godina; i</p> <p>1.6. u slučajevima kada sudija ili tužilac nije ponovo imenovan sa stalnim mandatom.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 34 Lirimi nga funksioni</p> <p>1. Në rastet e dorëheqjes së gjyqtarit ose prokurorit, apo pensionimit të tij, Këshilli përkatës i dërgon propozimin Presidentit për lirim nga detyra.</p> <p>2. Presidenti brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për lirimin nga detyra të gjyqtarit, gjegjësisht prokurorit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 34 Release from duty</p> <p>1. In cases of resignation of judges or prosecutors, or their retirement, the respective Council shall submit a proposal to the President for their release from duty.</p> <p>2. The President shall issue a decree for the release of a judge or prosecutor within thirty (30) days of receiving the proposal.</p>	<p style="text-align: center;">Član 34. Udaljenje sa funkcije</p> <p>1. U slučaju ostavke sudije ili tužioca, ili njegovog penzionisanja, relevantni Savet dostavlja predlog Predsedniku za udaljenje sa funkcije.</p> <p>2. Predsednik, u roku od trideset (30) dana, nakon prijema predloga, donosi dekret o udaljenju sa funkcije sudije, odnosno tužioca.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 35 Shkarkimi i gjyqtarit dhe prokurorit</p> <p>1. Gjyqtari dhe prokurori mund të shkarkohet nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose në rastet kur gjyqtari ose prokurori është vlerësuar dy (2) herë radhazi me performancë të dobët, ose është vërtetuar se ka pasuri të pajustificueshme, ose ka bërë shkelje të rënda disiplinore, sikurse përcaktohet me ligj.</p> <p>2. Gjyqtari dhe prokurori ka të drejtë të ankohet ndaj vendimit mbi shkarkimin drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.</p> <p>3. Këshilli përkatës, para dërgimit të propozimit për shkarkim të gjyqtarit, gjegjësisht prokurorit, siguron që të jenë përfunduar të gjitha procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>4. Propozimi për shkarkimin e gjyqtarit, gjegjësisht prokurorit, i dërgohet Presidentit nga Këshilli</p>	<p style="text-align: center;">Article 35 Dismissal of judges and prosecutors</p> <p>1. A judge and prosecutor may be dismissed from office due to conviction for a serious criminal offence or in cases where a judge or prosecutor have been evaluated as having a poor performance twice (2), or it has been proven that he/ she has unjustified assets, or has committed serious disciplinary violations, as defined by Law.</p> <p>2. The judge and prosecutor shall have the right to appeal directly to the Supreme Court of Kosovo against the decision on dismissal.</p> <p>3. The relevant Council shall, before submitting the proposal for the dismissal of a judge or prosecutor, ensure that all relevant procedures have been completed in accordance with the applicable legislation.</p> <p>4. The proposal for the dismissal of a judge or prosecutor shall be submitted to President by</p>	<p style="text-align: center;">Član 35. Razrešenje sudije i tužioca</p> <p>1. Sudije i tužioci mogu biti razrešeni sa funkcije zbog osude za teško krivično delo, ili u slučajevima kada je sudija ili tužilac ocenjen dva (2) puta zaredom sa slabim učinkom, ili je dokazano da ima neopravdanu imovinu, ili je počinio ozbiljni disciplinski prekršaj, kao što je utvrđeno zakonom.</p> <p>2. Sudija i tužilac ima pravo žalbe na odluku o razrešenju direktno Vrhovnom sudu Kosova.</p> <p>3. Relevantni savet, pre dostavljanja predloga za razrešenje sudije, odnosno tužioca, obezbeđuje da su sprovedeni svi odgovarajući postupci u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>4. Relevantni savet dostavlja predsedniku predlog za razrešenje sudije, odnosno</p>

<p>përkatës. Ky propozim përfshin një raport me shkrim dhe propozimin e Këshillit përkatës për shkarkimin e gjyqtarit, gjegjësisht prokurorit.</p> <p>5. Presidenti, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për shkarkimin e gjyqtarit, gjegjësisht prokurorit, të propozuar nga Këshilli përkatës. Nëse brenda këtij afati Presidenti nuk e shkarkon gjyqtarin, gjegjësisht prokurorin, Këshilli përkatës paraqet edhe një herë tjetër propozimin me arsyetimin plotësues në formë të shkruar. Pas këtij propozimi, Presidenti shkarkon gjyqtarin, gjegjësisht prokurorin.</p> <p>6. Para zbatimit të vendimit të tillë, gjyqtari, gjegjësisht prokurori, njoftohet zyrtarisht nga Këshilli përkatës lidhur me vendimin e Presidentit për miratimin apo mosmiratimin e shkarkimit nga detyra.</p>	<p>the relevant Council. This proposal shall include a written report and the proposal of the relevant Council for the dismissal of the judge or prosecutor.</p> <p>5. The President shall, within a period of thirty (30) days after receiving the proposal, issue a decree on the dismissal of the judge or prosecutor proposed by the relevant Council. If within this period, the President does not dismiss the judge or prosecutor, the relevant Council shall submit the proposal once again with supplementary reasoning in writing. After this proposal, the President shall dismiss the judge or prosecutor.</p> <p>6. Before the implementation of such a decision, the judge or prosecutor shall be officially notified by the relevant Council regarding the President's decision to grant or reject the dismissal.</p>	<p>tužioca. Ovaj predlog sadrži izveštaj u pisanoj formi i predlog relevantnog Saveta za razrešenje sudije, odnosno tužioca.</p> <p>5. Predsednik, u roku od trideset (30) dana, nakon prijema predloga, donosi dekret o razrešenju sudije, odnosno tužioca, na predlog relevantnog Saveta. Ako u ovom roku Predsednik ne razreši sudiju, odnosno tužioca, relevantni Savet još jednom podnosi predlog u pisanoj formi sa dopunskim obrazloženjem. Nakon ovog predloga, Predsednik razrešava sudiju, odnosno tužioca.</p> <p>6. Pre sprovođenja takve odluke, relevantni Savet službeno obaveštava sudiju, odnosno tužioca, o odluci Predsednika za odobrenje ili odbijanje razrešenja dužnosti.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER VIII FINAL AND TRANSITIONAL PROVISIONS</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE VIII PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE</p>
<p style="text-align: center;">Neni 36 Nxjerrja e akteve nënligjore</p> <p>Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë Ligj miratohen në afat prej gjashtë (6) muaj nga hyrja në fuqi e këtij Ligji. Deri në miratimin e tyre, zbatohen aktet nënligjore në fuqi, me kusht që nuk janë në kundërshtim me përcaktimet e këtij Ligji.</p>	<p style="text-align: center;">Article 36 Issuance of bylaws</p> <p>The bylaws specified by this Law shall be adopted within a period of six (6) months from the entry into force of this Law. Until their approval, the existing bylaws shall apply, provided that they are not in contradiction with the provisions of this Law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 36. Donošenje podzakonskih akata</p> <p>Podzakonski akti utvrđeni ovom zakonom, donose se u roku od šest (6) meseci od stupanja na snagu ovog Zakona. Do njihovog donošenja, primenjuju se važeći podzakonski akti, pod uslovom da nisu u suprotnosti sa odredbama ovog Zakona.</p>

<p align="center">Neni 37 Shfuqizimi i dispozitave tjera ligjore</p>	<p align="center">Article 37 Repeal of other legal provisions</p>	<p align="center">Član 37. Ukidanje drugih zakonskih odredbi</p>
<p>1.Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohen:</p> <p>1.1. Neni 30, Neni 31, Neni 32, Neni 33, Neni 34, Neni 35, Neni 36, Neni 37, Neni 38, Neni 40 dhe Neni 41 i Ligjit Nr. 06/L-54 për Gjykatat;</p> <p>1.2. Neni 20, Neni 21, Neni 22, Neni 23, Neni 24, Neni 25, Neni 26, Neni 32, Neni 39 dhe Neni 40 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;</p> <p>1.3. Neni 20, Neni 21, Neni 23, Neni 24, Neni 25, Neni 26, Neni 34 dhe Neni 35 i Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;</p> <p>1.4. Neni 24, Neni 25, Neni 26, Neni 27, Neni 33, Neni 35, Neni 36, Neni 37, Neni 38 dhe Neni 39 i Ligjit Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit.</p>	<p>1.The following shall be repealed upon the entry into force of this Law:</p> <p>1.1. Article 30, Article 31, Article 32, Article 33, Article 34, Article 35, Article 36, Article 37, Article 38, Article 40 and Article 41 of Law No. 06/L-54 on Courts;</p> <p>1.2. Article 20, Article 21, Article 22, Article 23, Article 24, Article 25, Article 26, Article 32, Article 39 and Article 40 of Law No. 06/L-055 on Kosovo Judicial Council;</p> <p>1.3. Article 20, Article 21, Article 23, Article 24, Article 25, Article 26, Article 34 and Article 35 of Law No. 06/L-056 on Kosovo Prosecutorial Council;</p> <p>1.4. Article 24, Article 25, Article 26, Article 27, Article 33, Article 35, Article 36, Article 37, Article 38 and Article 39 of Law No. 08/L-167 on State Prosecutor.</p>	<p>1. Stupanjem na snagu ovog Zakona ukidaju se:</p> <p>1.1. Član 30, član 31, član 32, član 33, član 34, član 35, član 36, član 37, član 38, član 40 i član 41. Zakona br. 06/L-54 o sudovima;</p> <p>1.2. Član 20, član 21, član 22, član 23, član 24, član 25, član 26, član 32, član 39 i član 40. Zakona br. 06/L-055 o Sudskom savetu Kosova;</p> <p>1.3. Član 20, član 21, član 23, član 24, član 25, član 26, član 34 i član 35. Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom savetu Kosova;</p> <p>1.4. Član 24, član 25, član 26, član 27, član 33, član 35, član 36, član 37, član 38 i član 39. Zakona br. 08/L-167 o Državnom tužiocu.</p>
<p align="center">Neni 38 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p align="right">Glauk Konjufca</p> <hr/> <p align="center">Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p align="center">Article 38 Entry into force</p> <p>This Law shall enter into force fifteen (15) days after its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p align="right">Glauk Konjufca</p> <hr/> <p align="center">Speaker of the Assembly of the Republic of Kosovo</p>	<p align="center">Član 38. Stupanje na snagu</p> <p>Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana nakon objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p> <p align="right">Glauk Konjufca</p> <hr/> <p align="center">Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p>